

Gazetari, Betim Musliu i quan arrestimet e fundit të personave që dyshohen për terrorizëm filma të Hollywood-it.

Musliu, në një diskutim për rolin e medias në stigmatizimin e grupeve të ndjeshme, ka thënë që raportimet e gazetarëve mbi arrestimet e këtyre personave, kanë qenë të tmerrshme.

"Raportimet e arrestimit të këtyre personave kanë qenë të tmerrshme. Këto raporte të gazetarëve lidhur me arrestimet, janë bërë me një praktikë të mbrapsht ,duke bërë që të zbulohet identiteti i të gjithë protagonistëve të arrestuar duke mos mbrojtur asnjë të dhënë personale të tyre".

Sipas tij, është bërë një shkelje flagrante ndaj këtyre personave.

"Ekziston mundësia e pafajësisë së tyre, ku askush nuk mund të jetë i dënuar, përderisa nuk shpallet përmes një aktgjykimi fajësia e tyre. Kjo është një shkelje flagrante ndaj këtyre personave", ka thënë Musliu./Infodirekt/